

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten e kësaj Gjykate, Edona Selimi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B.Sh. nga ..., të cilin sipas autorizimit e mbronë av. Xh.Xh. nga ..., për veprën penale, **Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.1416/2016, të datës 17.08.2016, e sipas Marrëveshjes për pranimin e fajsisë, të datës 16.07.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, më datën 16.07.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më dt. 20.07.2018, përpiloi këtë:**

AKT GJYKIM

I akuzuari B.Sh., nga babai R. dhe nëna T., e lindur D., i lindur më datë ... në ..., ku edhe jeton ne lagjen “ ... ” rr. “ ... ” nr. ..., i martuar, baba i nje femiu, ka te kryer shkollen fillore, i punesuar ne Zvicerr, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa denuar me pare dhe nuk udhehiqet procedures tjeter penale ndaj tij,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datë 24.07.2016, rreth orës 04:00 minuta, në rrugën “Ropotovë-Perlepnice-Gjilan”, me te kaluar rrugen e restorantit “Vali Ranch”, duke e drejtuar automjetin e udhetareve te markes “Mercedes-Benz CL63” me ngjyre te zeze dhe targa te regjistrimit ..., ka shkelur paragrafin 1 te nenit 54 te Ligjit per Sigurine te Komunikacionit Rrugor dhe ka rrezikuar jeten e njerezve dhe pasurine, ne ate menyre qe nuk iu eshte permbajtur dispozitave te lartepemendura te ligjit ne fjale qe kane te bejne me obligimin e shoferit qe automjetin ta ngase me shpejtesi adekuate dhe sjellje e cila lejon qe ta kontrolloj automjetin, ne kushte ekzistuese te komunikacionit, posacerisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmerine e rruges, kushtet dhe ngarkesen e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendesine e komunikacionit ne menyre qe mjetin e vet ta ndale para cdo pengese, lehte ka menduar se edhe perkunder ketyre leshimeve nuk do te shkaktoj pasoje te ndaluar, ashtu qe me te arritur ne vendin e permendur e humbe kontrollin mbi automjet, del ne shiritin e anes se majte te drejtimit te levizjes, me c’rast per vec demeve materiale ne automjetin e vellait R.Sh. nga ..., lendime te lehta trupore iu kishte shkaktuar edhe bashkeshortes dhe vajzes se vet – bashkeudhetareve – tani te demtuarave: L. dhe V.Sh., qe te dyja nga Gjilani, ne te dy rastet ne forme te ndrydhjeve te indeve te buta te kraharorit,

*-me çka ka kryer veprën penale, **Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,22,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:*

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **250 (dyqindpesedhjetë) €**, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguajë në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj me dënim burgu, ashtu që do t'i llogaritet shuma prej 20 € për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që të paguajë **paushallin gjyqësor** në shumën prej **20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par. 3 nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit i shqiptohet edhe **taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €**.

Pala e demtuar **udhezohet ne kontest civil per realizimin e kerkeses pasurore juridike.**

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP. II nr. 1416/2016, të datës 17.08.2016, kundër të akuzuarit B.Sh., për vepër penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritator sipas ligjit.

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, përmes prokurorit të shtetit, Ismet Ukshini, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin B.Sh. dhe mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av. Xh.Xh..

Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 16.07.2018, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurori në fjalë, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr.1416/2016, të datës 16.07.2018.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Xh.Xh., deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjithashtu kërkoi nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje, pasi që i mbrojturi i tij është pajtuar me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit te Shtetit.

I pandehuri B.Sh., deklaroi se e mbështetë në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij, pasi që marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësin e tij, është përnduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkoi nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje. Gjithashtu në fjalën përfundimtare deklaroi se është përnduar dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë,

nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, e as prokurores së shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, pranoi fajësinë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me të do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK - së.

Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 996/2016, më datë 20.07.2018**

**Praktikantja,
Edona Selimi**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.